

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 237/ 2023, 03-11-2023****Parashikimi** nga 03-11-2023, ora 12:00 deri më 04-11-2023, ora 23:59.**PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET**

Gjatë pasdites së sotme (e premte, dt.03) dhe ditën e nesërme (e shtunë, dt.04) do të ketë reshje me intensitet të lartë në të gjithë vendin. Në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve. Përsa i përket lumenjve të mëdhenj, ata nuk përbejnë rrezik për përmytje.

PARASHIKIMI METEO**RESHJET**

Sot pasdite (e premte, dt. 03) dhe nesër (e shtunë, dt. 04) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarqet Elbasan, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje intensive (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Reshjet do të shoqërohen me shtrëngata në të gjithë vendin.

TEMPERATURAT

Nesër (e shtunë, dt. 04) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 14 / 18 °C
në vendet e ulëta: 10 / 18 °C
në vendet malore: 6 / 14 °C

ERA

Sot pasdite (e premte, dt. 03) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë, për momente deri shumë e fortë, në bregdet dhe në zonat malore. Nesër (e shtunë, dt. 04), era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare.

NIVELET E RREZIKUT**S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: Elvin Çomo

Koordinator: Elona Abazi (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 1 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)



































Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 237/ 2023, 03-11-2023


Parashikimi nga 03-11-2023, ora 12:00 deri më 04-11-2023, ora 23:59.

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive					
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive					
DIBËR	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
LEZHË	S'KA RREZIK	intensive					
DURRËS	S'KA RREZIK	intensive					
TIRANË	S'KA RREZIK	intensive					
ELBASAN	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
FIER	S'KA RREZIK	intensive					
BERAT	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
KORÇË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
VLORE	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				

LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.



RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 03 – 04.

LEGJENDA: Zjarre në pyje

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

SIMBOLE

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke